

COVID-19 | Maatregelen | 01/12/2020

Albanees | Vertaald uit het Nederlands

## Masat që merren nga 1 dhjetori

### Hyrje

Qeveria ka vënë rregulla për të ndaluar koronavirusin. Respektoji rregullat! Kështu ti nuk sëmuresh, apo nuk mund të sëmuresh asnjëri. Policia mund të të kontrollojë.

Vini re: Disa qytete/bashki dhe komuna kanë rregulla shtesë. Shiko faqen e internetit të qytetit/bashkisë apo të komunës.

### Rregullat shumë të rëndësishme

- Laji shpesh duart e tua me ujë dhe sapun!
- Mbaj/vëre një maskë për gojë!
- Mbaj minimumi 1,5 metra distancë nga personat e tjerë!
- Mbaj kontakt të afërt me maksimumi 1 person. Mbajtja e 1,5 metra distancë me kontaktin tënd të afërt nuk është e nevojshme.
- Bëj kujdes edhe më tepër tek pacientët e rrezikueshëm :
  - njerëzit më të moshuar se 65 vjeç,
  - njerëzit me probleme të zemrës, mushkërive apo veshkave,
  - njerëzit që infektohen lehtësisht.
- Puno nga shtëpia jote.
- Ajros mirë: hapi dritaret.
- Është mira t'a lësh të takohesh me të tjerë përjashta.

### Të shkosh në një qytet apo shtet tjetër

- Në Belgjikë :
  - Lejohet të udhëtosh kudo.
  - Nëse ti përdor transportin publik (autobus, tramvaj apo tren) dhe nëse ti ke moshë më të madhe se 12vjeç, atëherë ti duhet mbash një maskë për gojë ose një shall mbi gojën dhe hundën tënde. Kjo është e detyrueshme.
  - Nuk lejohet të dalësh në rrugë nga ora 24 e natës deri në ora 5 e mëngjesit.
- Me pushime jashtë shtetit :
  - Është mira që të mos shkosh jashtë shtetit. Ky është këshillim.
  - Nëse megjithatë ti duhet të shkosh jashtë shtetit, atëherë janë 3 lloje zonash.
    - ▶ Lejohet të udhëtosh për në zonat e gjelbra/jeshile. Kjo gjë është e sigurtë (pa rrezik).

- ▶ Është mira të mos udhëtosh për në zonat e kuqe apo portokalle.
- ▶ Shiko në faqen e internetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme: [diplomatie.belgium.be](https://diplomatie.belgium.be).
- Çdo shtet mund të ketë rregulla të tjerë. Kontrollloji rregullat në [https://diplomatie.belgium.be/nl/Diensten/Op\\_reis\\_in\\_het\\_buitenland/reisadviezen](https://diplomatie.belgium.be/nl/Diensten/Op_reis_in_het_buitenland/reisadviezen)
- Ti duhet të plotësosh një formular para se të kthehesh në Belgjikë. Këtë formular mund t'a gjesh në: <https://travel.info-coronavirus.be/nl/public-health-passenger-locator-form>.
- Nëse ishe në një zone të kuqe për më gjatë se 48 orë, atëherë këto 3 gjëra duhet t'i bësh pa dyshim kur kthehesh në Belgjikë:
  - 1 Ti duhet të plotësosh formularin në: <https://travel.info-coronavirus.be/nl/public-health-passenger-locator-form>
  - 2 Nëse merr një SMS atëherë është e detyrueshme të rrish në karantinë. Ti duhet të rrish në shtëpi për minimumi 10 ditë. Dil përjashta vetëm nëse duhet me do e mos!. Për shembull: për të shkuar tek farmacia, mjeku apo në supermarket. Në atë rast mbaj gjithmonë një maskë për gojë!
  - 3 Nëse nuk merr një SMS, atëherë nuk duhet të rrish në karantinë.

## Punë

- Puno nga shtëpia! Kjo është e detyrueshme.
- Nëse, megjithatë, ti duhet të shkosh në punën tënde për të punuar, atëherë
  - Ti duhet të mbash/vendosësh një maskë për gojë.
  - Ajros mirë: hapi dritaret!
- Nëse ke pyetje, merr informacione nga shefi yt.

## Dyqanet

- Të gjithë dyqanet janë hapur.
  - Shko në dyqan vetëm!
  - Lejohet të shkosh në dyqan bashkë me fëmijë nën moshën 18 vjeç. Bëje këtë sa më pak të jetë e mundur!
  - Nëse hyn në dyqan, atëherë dizinfektoi më parë duart e tua!
  - Lejohet të bësh blerjen (të rrish brenda dyqanit) për maksimumi 30 minuta.
  - Vendos/mbaj një maskë për gojë! Kjo është e detyrueshme.
- Ka tregje (tregjet hapur). Tregjet e gjërave të përdorura, pazaret e dimrit dhe për festa nuk lejohen.
- Dyqani i natës është hapur deri në ora 22 e mbrëmjes.
- Nuk lejohet të blesh pije alkoolike pas orës 20 të mbrëmjes.
- Berberët/floktoret dhe sallonet e bukurisë janë mbyllur.

## Hotel restorant kafe

- Kafetë dhe restorantët janë të mbyllur.
- Ti mund të shkosh të marrësh ushqime deri në ora 22 e mbrëmjes

### Kontakt social

- Lejohet të kesh kontakte të afërt me maksimumi 1 të njëjtin person. Në këtë rast 1,5 metra distancë nuk është e nevojshme.
- Nëse fton dikë në shtëpinë tënde, atëherë lejohet që të ftosh maksimumi 1 kontakt të afërt për familje.
- Nëse banon vetëm, atëherë ti lejohet të ftosh në shtëpinë tënde kontaktin tënd të afërt dhe një person tjetër. Nuk lejohet që këta persona të jenë në shtëpinë tënde në të njëjtin moment.
- Nëse dilni bashkë me të tjerë në rrugë, atëherë lejohet të jeni me maksimumi 4 persona. Ti duhet të mbash 1,5 metra distancë. Fëmijët nën 12 vjeç nuk llogariten këtu.

### Ditët e festave

- Nëse banon vetëm, atëherë më 24 ose më 25 dhjetor lejohet që personi yt i kontaktit të afërt dhe një person tjetër të jenë bashkë (në të njëjtin moment) në shtëpinë tënde. Ky është një përjashtim.
- Fishekzjarret janë të ndaluar.

### Lëvizje / aktivitet fizik

- Lejohet të bëhet sport përjashta me maksimumi 4 persona bashkë. Mbaj 1,5 metra distancë!
- Klubet sportive, qendrat e wellness-it dhe qendrat e fitnesit janë mbyllur.
- Pishinat janë hapur.

### Koha e lirë

- Gjithçka është mbyllur. Për shembull: kinematë, kazinotë, parqet tematikë (me lojra) dhe kopshtet zoologjikë.
- Nuk ka aktivitete/evenimentë apo shfaqje. Për shembull: thetër apo koncerte.
- Bibliotekat rrijnë akoma hapur.
- Këndet e lodrave përjashta rrijnë akoma hapur.
- Muzetë janë hapur.

### Besim fetar

- Nuk ka shërbime fetare.
- Ndërtesat fetare janë hapur.
  - Lejohet të jenë maksimumi 4 persona bashkë.
  - Mbaj 1,5 metra distancë!
  - Ti duhet të mbash një maskë për gojë.
- Lejohet të bëhen ceremonitë e varrimit me 15 persona. Nuk lejohet të ofrohet ushqim më pas.
- Lejohet të bëhen festat e martesave. Kjo lejohet vetëm me çiftin, maksimumi 2 dëshmitarë, nëpunësin titular të gjendjes civile ose klerikun (për shembull priftin ose imamin/hoxhën).

### Çerdhe dhe shkolla

- Çerdhet janë hapur.

- Nxënësit mund të shkojnë në shkollë. Shkolla jote të jep informacione të mëtejshëm.

### Inkurajim / nxitje

Këta rregulla janë të rëndësishëm për shëndetin e gjithësecilit. Gjithësecili duhet t'i rrespektojë ata.

Faleminderit që do të bësh këtë gjë! Së bashku, ne e ndalojmë koronavirusin.